

UDHËZIM I LISTIMIT
NË
BURSËN SHQIPTARE TË TITUJVE ALSE

Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.43, datë 13.05.2020

Ndryshuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.51, datë 18.03 2022

Kapitulli I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky udhëzues ka për objekt të shpjegojë zbatimin e dispozitave të Rregullores së Bursës Shqiptare të Titujve ALSE duke përcaktuar udhëzime për Emetuesin lidhur me:

- 1) Procesin e emetimit dhe listimit në Bursë;
- 2) Procedurat e transferimit të titujve në segmentet e Bursës ALSE;
- 3) Procedurat e delistimit të titujve nga Bursa ALSE;
- 4) Procedurat dhe detyrimet e kompanive të listuara për të bërë transparent dhe shpërndarë informacione në Bursën ALSE dhe në publik.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë rregullore termat si më poshtë:

- 1) **Agjenti Tregtar** – do të nënkuptojë çdo ndërmjetës financiar të përcaktuar nga Emetuesi për të realizuar për llogari të këtij të fundit procesin e shitjes të titujve me ofertë publike (ose private) tek investuesit si dhe grumbullimin e vlerave monetare (*cash*). Shërbimi i Agjentit Tregtar është shërbim plotësues dhe i ndryshëm nga shërbimi i Nënshkrimit të titujve. Agjenti tregtar lehtëson shitjen e titujve në Ofertën Publike duke i ofruar Emetuesit rrjetin e shpërndarjes në të gjithë shtrirjen gjeografike brenda dhe ose jashtë vendit;
- 2) **ALSE** – do të nënkuptojë subjektin Bursa Shqiptare e Titujve ALSE;
- 3) **Autoriteti Kompetent** – autoriteti publik ose organi vetrregullator që ka juridiksion mbi çështjen përkatëse;
- 4) **Emetuesi** - çdo person juridik, Titujt (ose çdo klasë Titujsh) e të cilit janë pranuar, ose i nënshtrohen një aplikimi për t'u pranuar në listim dhe/ose tregtim në ALSE;
- 5) **Përqindja e Aksioneve në Zotërim të Publikut (PAZoP)** - nënkupton atë pjesë të klasës së aksioneve të kompanisë (Emetuesit), e cila është e tregtuar publikisht në bursë ose në tregjet e organizuara, zotërohet nga të gjitha klasat e ndryshme të investuesveve (profesionalë ose jo-profesionalë) dhe janë lirisht të transferueshëm pa asnjë kufizim (njihet ndryshe edhe si *Free Float*). Ajo përlogarit si përqindje e raportit mes aksioneve në zotërim të publikut, që janë të listuara në bursë dhe totalit të klasës së aksioneve që ka emetuar kompania (Emetuesi). Pjesa tjetër e aksioneve që nuk tregtohen lirisht në bursë, apo në një treg të organizuar, janë aksione që u përkasin aksionarëve themelues, apo menaxherëve të kompanisë (Emetuesit), dhe zakonisht janë aksione nominative e që nuk janë lirisht të transferueshme (locked-in shares);
- 6) **Kalendari Financiar** – Kalendari i njoftimeve të kompanisë lidhur me veprimet korporative dhe publikimeve vjetore që janë me rëndësi të veçantë, si për investuesit, ashtu dhe palët e tjera të interesuara;
- 7) **Listim** – është procesi i regjistrimit të një titulli në një nga segmentet e tregut të një Burse titujsh, me qëllim tregtimin e lirshëm mes investuesve;
- 8) **Underwriting** - nënkupton procesin nëpërmjet të cilit një institucion i specializuar (bankë ose firmë brokerimi) blen të gjithë apo një pjesë të Ofertës Publike të titujve për llogari të portofolit të vet (duke mbajtur rrezikun e mosshitjes) me qëllim shitjen të investuesit, dhe/apo thjesht bën përpjekjet më të mira për të shitur titujt në Ofertë Publike tek investuesit pa marrë asnjë rrezik.
- 9) **Rregullat e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE** – tërësia e rregullave, rregulloreve dhe udhëzimeve të miratuara nga Bursa ALSE;
- 10) **Segmentet e Tregut** – do të nënkuptojnë Tregun Kryesor, Standard dhe Hyrës, sipas specifikimeve të përcaktuara në Rregulloren e Bursës ALSE;

- 11) **Veprime Korporative** –nënkuptojnë të gjitha veprimet e kompanisë që ka emetuar/listuar titujt (Emetuesi) në Bursën ALSE, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt ose të tërthortë në çmimin e tregut të këtyre titujve, duke përfshirë, por pa u kufizuar me: ndryshimin e simbolit të titullit, ndarjen ose bashkimin e aksioneve, deklarimin dhe ekzekutimin e dividendit në të gjithë fazat e procesit të tij, deklarimi dhe shpërndarja e të drejtave të parablerjes së aksioneve në të gjithë fazat e procesit të tij, deklarimi dhe shpërndarja e kuponit në të gjithë fazat e procesit të tij, bashkimi dhe blerja, likuidimi ose shpërbërja, etj;
- 12) **Vlerësimi Financiar (Due-Diligence)** – do të nënkuptojë përcaktimin e vlerës së kompanisë me Ofertë Publike (ose private), duke u bazuar kryesisht te pasqyrat financiare;

Kapitulli II: PROCESI I EMETIMIT TË TITUJVE DHE LISTIMIT NË BURSË

Neni 3

Emetimi i Titujve

Emetimi i titujve është procesi i hedhjes (shitjes) së titujve në qarkullim nga një person juridik, me qëllim rritjen e kapitalit në tregun primar nëpërmjet huamarrjes, apo ftesës për bashkëpronësi në kapital nga publiku investues.

Neni 4

Tregjet ku Emetohen Titujt

Titujt e emetuar nga persona juridik (Emetuesit) tregtohen në këto tregje:

- 1) **Tregu Primar** – është tregu ku Emetuesi hedh (shet) për herë të parë titujt e tij te investuesit me qëllim rritjen e kapitalit nëpërmjet huamarrjes (tituj borxhi), ose kapitalit (aksione).

Forma e emetimit të titujve në tregun primar ndodh nëpërmjet:

- a) **Ofertës Private** – titujt u ofrohen një numri të kufizuar investuesish, kryesisht investuesve profesionalë, të cilët kanë aftësi dhe kapacitete të vlerësojnë rrezikun. Në ofertën private Emetuesi e zgjedh vet se cilëve nga investuesit që kanë shprehur interes do t'u jepet e drejta për të blerë titujt e emetuar;
- b) **Oferta Publike** - titujt u ofrohen nëpërmjet kanaleve publike të komunikimit një numri të papërcaktuar investuesish profesionistë ose jo profesionistë. Oferta publike kërkon me detyrim listimin e titujve në një treg të rregulluar (Bursë), me qëllim ofrimin e një mundësie likuiditeti për investuesit. Në ofertën publike, Emetuesi nuk përcakton investuesit.

Subjekt i këtij udhëzimi do të jetë procedura e Ofertës Publike të titujve dhe listimi i tyre në Bursë.

- 2) **Tregu Sekondar** – është çdo lloj tregu ku zotëruesit e titujve (investuesit) mund t'i ri-shesin ato tek investues të tjerë, për qëllim likuiditeti. Tregu sekondar mund të jetë i organizuar dhe me rregulla të forta (Bursa) ose i pa-organizuar dhe me rregulla më fleksibël (tregu – mbi – banak ose OTC).

Neni 5

Emetimi i Titujve në Tregun Primar nëpërmjet Ofertës Publike

Para se një Emetues të listojë një titull në Bursë, fillimisht duhet të përgatitet për procedurat e daljes me Ofertë Publike.

Hapat që duhet të ndiqen nga Emetuesi në Tregun Primar për emetimin e titujve me Ofertë Publike janë:

- 1) Të marrë vendim të organeve drejtuese (Asambleja e Aksionareve) për emetimin;
- 2) Ndryshimin e statusit juridik, nga një formë tjetër, në Shoqëri Aksionare (kur është e aplikueshme);
- 3) Të zgjedhë, kur e sheh të arsyeshme, një ndërmjetës financiar (Bankë ose Firme Brokerimi), e cila kryen procesin e Vlerësimit Financiar (Due-Diligence) dhe përcaktimin e çmimit të titullit,
- 4) Të vendosë cilën nga metodat e Ofertës Publike do zgjedhë të realizojë me apo pa Underwriting;
- 5) Të përcaktojë cilën bankë do të përdorë si Agjent Tregtar të titujve në sportel (nëse është i ndryshme nga Nënshkruesi i Titujve që bën Vlerësimin Financiar);
- 6) Të përgatisë dosjen e Prospektin (pasaporta informative e emetimit) për ta dorëzuar pranë Autoritetit Kompetent;
- 7) Të përgatisë dosjen e Listimit të titujve në Bursë;
- 8) Të marrë miratimin me shkrim nga Autoriteti Kompetent për Prospektin e emetimit të titujve;
- 9) Të fillojë përgatitjet për publikimin në media dhe marketimin e procesit të Ofertes Publike (i njohur ndryshe si procesi i Road-Show).

Neni 6

Karakteristikat e Veçanta të Ofertës Publike të Aksioneve

Nëse subjektet e Ofertës Publike janë aksionet e një kompanie (Emetuesi), e cila hedh në qarkullim (emeton/shet) për herë të parë një klasë të caktuar aksionesh, atëherë ajo quhet Ofertë Publike Fillestare (OPF).

Çdo emetim shtesë të së njëjtës klasë aksionesh që bën për publikun Emetuesi në vijimësi (pas OPF), me qëllim rritjen e kapitalit, quhet Ofertë Publike Sekondare (OPS).

Gjatë organizimit të Ofertës Publike Fillestare të aksioneve të një Emetuesi në Bursën ALSE, përqindja minimale e aksioneve në zotërim të publikut (PAZoP), përcaktohet qartë në Rregulloren e Bursës ALSE sipas segmentit të tregut ku do të listohen këto tituj.

Çdo Ofertë Publike Sekondare pas Ofertës Publike Fillestare e rrit përqindjen e aksioneve në zotërim të publikut (PAZoP). Formula e përlogaritjes së PAZoP pas përfundimit të Ofertës Publike Sekondare të rradhës do të jetë si vijon:

$$\frac{\text{Nr. Aksioneve OPF} + \text{Nr. Aksione OPS1} + \text{Nr. Aksione OPS2} + \dots + \text{Nr. Aksione OPSn}}{\text{Nr. Total i Aksioneve Ekzistuese} + \text{Nr. i Aksioneve të reja në OPSn}}$$

Neni 7

Mënyrat dhe procedurat e emetimit në Tregun Primar

Një emetues mund të përgatisë Ofertën Publike nëpërmjet dy mënyrave kryesore:

- 1) Përgatitja e Ofertës Publike duke përzgjedhur një Ndërmjetës Financiar, i cili bën Underwriter, në të cilën përdoret njëra nga mënyrat e përfshira si më poshtë:
 - a) Metoda e Përpjekjeve më të Mira (Best Efforts):
 - Ndërmjetësi Financiar nuk mban rrezikun e Emetuesit të Titujve;

- Ndërmjetësi Financiar garanton që do përpiqet me të gjitha mënyrat më të mira, për të shitur titujt e emetuar;
- Ndërmjetësi Financiar nuk garanton shitjen, si dhe nuk blen titujt e pasitur.

b) Metoda e Underwriting:

- Ndërmjetësi Financiar blen të gjithë titujt (ofertën) e disponueshme për t'u tregtuar, me një çmim më të lirë se çmimi i tregut, duke marrë mbi vete rrezikun e mosshitjes së tyre tek investuesit e tjerë në tregun sekondar (Bursë);
- Ndërmjetësi Financiar mund ta blejë një pjesë të titujve (ofertës) së disponueshme për t'u tregtuar, duke e ndarë pjesën tjetër të disponueshme me Ndërmjetës Financiarë të tjerë. Ky proces quhet Syndicated Underwriting.

2) Përgatitja e Ofertës Publike pa Ndërmjetës Financiar dhe pa Nënshkrim Titujsh (Direct Listing):

- a) Emetuesi mund të përzgjedhë ta kryejë vet procesin e Ofertës Publike, duke përdorur kanalet mediatike, si formë e tërheqjes së vëmendjes së investuesve. Në këtë formë Emetuesi synon të ulë kostot që do t'i paguante palëve të treta, por merr përsipër rrezikun e mosshitjes së titujve, nëse nuk ka interes të mjaftueshëm nga investuesit.
- b) Edhe në këtë mënyrë, Emetuesi është i detyruar të përdorë të paktën shërbimin e Agjentit Tregtar, i cili mundëson mbledhjen e ofertave nga investuesit (kur aplikohet), si dhe mbledhjen e fondeve nga investuesit të Emetuesi.

Neni 8

Aplikimi pranë Autoritetit Kompetent për miratimin e Ofertës Publike të Titujve

Askush në Republikën e Shqipërisë nuk mund të emetojë tituj me Ofertë Publike pa marrë më parë miratimin me shkrim nga Autoriteti Kompetent, sipas specifikimeve të kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi.

Emetuesi i titujve, aplikon për miratim të Ofertës Publike pranë Autoritetit Kompetent, duke vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga rregullatori në përputhje të plotë me kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi.

Neni 9

Aplikimi pranë Bursës ALSE për miratimin Listimin e Titujve

Paralelisht me procesin e miratimit me shkrim të Ofertës Publike të titujve nga Autoriteti Kompetent, Emetuesi duhet të aplikojë për listimin e titujve pranë një burse titujsh apo tregu të rregulluar të licencuar nga Autoriteti Kompetent, siç është Bursa ALSE.

Emetuesi i titujve, aplikon për pranimin për listim/tregtim të titujve pranë Bursës ALSE, sipas specifikimeve në paragrafin e parë të këtij neni. Emetuesi i vë në dispozicion bursës të gjithë dokumentacionin e kërkuar për listimin/tregtimin e titujve sipas klasave të caktuara dhe kriterëve të tjera të Bursës ALSE, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi.

Mospranimi për listim/tregtim në një bursë sipas paragrafit të parë të këtij neni, është kriter skualifikues për miratimin e emetimit të titujve me Ofertë Publike nga Autoriteti Kompetent.

Neni 10

Regjistrimi i Titujve në Formë Elektronike

Në bursë listohen dhe tregtohen vetëm titujt të cilët janë lirisht të transferueshëm mes palëve në transaksion.

Për të mundësuar një transferim sa më të shpejtë në kohë dhe sa më me pak kosto mes palëve, titujt që tregtohen në Bursën ALSE duhet të jenë të regjistruar në formë të dematerializuar në një institucion të specializuar (regjistrar dhe/apo depozitar titujsh), me të cilin bashkëpunon bursa dhe që është i licencuar nga Autoriteti Kompetent.

Neni 11

Prospekti dhe Miratimi nga Autoriteti Kompetent

Prospekti është një material specifik i përgatitur nga Emetuesi dhe/ose një person/fizik i autorizuar prej tij, i cili përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që do t'i duhej investuesit të dinte, para se të vendosë të investojë në titujt e Emetuesit që janë subjekt i Ofertës Publike.

Formati i prospektit dhe informacioni i detyrueshëm për t'u përfshirë në të përcaktohen nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

Prospekti duhet të miratohet nga Autoriteti Kompetent, në mënyrë që më pas të lejohet publikimi i tij për investuesit.

Emetuesi e publikon prospektin si pjesë e procesit të Ofertës Publike duke ftuar investuesit të blejnë titujt në proces emetimi vetëm pas miratimit me shkrim të Autoriteti Kompetent.

Neni 12

Hapja dhe Mbyllja e Ofertës Publike

Pas miratimit të Prospektit nga Autoriteti Kompetent, Emetuesi njofton publikisht nëpërmjet kanaleve mediatike datën e hapjes dhe mbylljes së Ofertës Publike.¹ Në të njëjtin njoftim, Emetuesi bën të ditur edhe Agjentin Tregtar dhe/apo Nënshkruesin e Titujve, si ndërmjetësit financiarë të ngarkuar për të realizuar Ofertën Publike si dhe adresën/at ku duhet të drejtohen investuesit e interesuar.

Agjenti Tregtar dhe/apo Nënshkruesi i Titujve janë përgjegjës mbledhjen e kërkesave të investuesve (kur aplikohet), nënshkrimin e kontratave si dhe mbledhjen e vlerave monetare (*cash*) që paguajnë blerësit (investuesit) si pasojë e procesit të investimit.

Pas datës së mbylljes së Ofertës Publike, Agjenti Tregtar dhe/apo Nënshkruesi i Titujve, llogarisin totalin e vlerave monetare të mbledhura nga investimit me sasinë e titujve të shitur, dhe rakordojnë veprimet me institucionin e specializuar (regjistrarin dhe/apo depozitarin e titujve) me të cilin bashkëpunon Bursa ALSE.

Pas rakordimit të parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, regjistri dhe/apo depozitari i titujve shpërndan titujt në llogaritë e investuesve, si dhe transferon tek Emetuesi totalin e vlerave monetare (*cash*) të siguruara nga shitja e titujve.

¹ Zakonisht kohëzgjatja e një Oferte Publike varion nga 2 deri në 4 javë.

Neni 13

Fillimi i Tregtimit në Bursë

Pas miratimit mbylljes së Ofertës Publike dhe procesit të rakordimit me regjistrarin dhe/apo depozitari i titujve, sipas parashikimeve në nenin 12 të këtij Udhëzimi, ky i fundit njofton Bursën ALSE në lidhje me gatishmërinë e procesit të klerimit dhe shlyerjes së titujve që do të tregtohen në vijimësi në bursë.

Bursa ALSE njofton publikisht nëpërmjet kanaleve mediatike datën e fillimit të tregtimit të titujve të Emetuesit në përputhje me kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi. Në të njëjtin njoftim, Bursa ALSE bën të ditur edhe Segmentin e Tregut ku është listuar titulli.

Në zbatim të këtij neni, Emetuesi, titujt e të cilit janë ofruar publikisht, duhet të jenë pranuar për listim nga Bursa ALSE sipas përkatimeve të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi, si dhe specifikisht në përputhje me Kapitullin III të këtij Udhëzimi.

Kapitulli III: PROCESI I LISTIMIT TË TITUJVE NË BURSË

Neni 14

Listimi në Bursë

Listimi i titujve në Bursë është procesi i regjistrimit të titujve në listën zyrtare të një burse titujsh me qëllim tregtimin e tyre ndërmjet investuesve të ndryshëm.

Procesi i listimit të titujve të ofruar me Ofertë Publike zhvillohet në Bursë (tregu sekondar).

Neni 15

Procesi i Listimit dhe Tregtimit të Titujve në Bursën ALSE

Procesi i listimit dhe tregtimit të titujve në Bursën ALSE si dhe detyrimet e vazhdueshme të Emetuesve për titujt e listuar në këtë treg të organizuar, realizohen në përputhje të plotë me Rregulloren e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE si dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi .

Neni 16

Segmentet e Tregut të Bursës

Bazuar në kriteret sasiore dhe cilësore të përcaktuara në Rregulloren e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE, titujt e Emetuesit mund të listohen/tregohen në një nga Segmentet e Tregut si më poshtë:

- 1) Tregu Hyrës;
- 2) Tregu Zyrtar Standard;
- 3) Tregu Zyrtar Kryesor.

Kriteret specifike dhe procedurat për listimin/tregtimin dhe shpërndarjen (klasifikimin) e titujve për regjistrim sipas këtyre Segmenteve të Tregut, realizohen në përputhje të plotë me Rregulloren e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE.

Kapitulli IV: PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË TITUJVE MIDIS SEGMENTEVE TE TREGUT NËBURSË

Neni 17

Mënyrat e Transferimit të Titujve në Segmentet e Tregut të Bursës

Transferimi i titujve në segmentet e Bursës ALSE mund të kryhet bazuar në rastet e mëposhtme:

- 1) Transferim me kërkesë të Emetuesit;
- 2) Transferim bazuar në vlerësimin, pas rishikimit periodik të kriterëve të listimit në Bursën ALSE;
- 3) Transferim nga Bursa ALSE në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme.

Miratimi/Refuzimi i transferimit të titujve në Segmentet e Tregut të bursës bëhet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bursës ALSE.

Neni 18

Aplikimi nga Emetuesi për Transferimin e Titujve

Bazuar në procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Bursës ALSE, Emetuesit mund të aplikojnë për transferimin e titujve nga një segment i tregut në një tjetër, duke përdorur "Shtojcën 1" bashkëngjitur këtij Udhëzuesi.

Neni 19

Transferimi i Titujve bazuar në Rishikimin Periodik të Kriterëve të Listimit

Rishikimet periodike kryhen për të përcaktuar nëse titujt e listuar në Segmentet e Tregut të bursës vazhdojnë të plotësojnë kriteret e likuiditetit në periudha 12 mujore.

Nëse, bazuar në Rregulloren e Bursës ALSE, konstatohet se titujt e Emetuesit nuk janë në përputhje me kriteret e likuiditetit gjatë dy (2) periudhash rishikimi të njëpasnjëshme, Bursa ALSE do të njoftojë me shkrim brenda 10 ditëve Emetuesin lidhur me këtë çështje.

Bazuar në plotësimin e kriterëve të likuiditetit, Bursa ALSE mund të ndërmarrë aplikime për transferimin e titujve në fjalë në një nivel më të lartë, ose më të ulët të segmentit të tregut të bursës. Bursa ALSE do të njoftojë jo më vonë se 3 (tre) ditë para transferimit të titujve në segmentet e tregut, Emetuesin dhe publikun.

Kriteret e likuiditetit për vlerësimin e përputhshmërisë së listimit/tregtimit të titujve në Segmentet e Tregut të Bursës ALSE përcaktohen nga kjo e fundit në një rregullore të veçantë.

Neni 20

Transferimi në Rast të Ngjarjeve të Veçanta

Në rastet e ngjarjeve të veçanta, Bursa ALSE mund shqyrtojë nëse, titujt për transferim nga një segment i tregut të Bursës në një tjetër, plotësojnë kriteret e likuiditetit të përcaktuara në Rregulloren e Bursës ALSE.

Rishikimi për të verifikuar plotësimin e kriterëve lidhur me ngjarjet e veçanta do të kryhet në rastet si më poshtë:

- 1) Ka ndryshime në veprimet korporative;
- 2) Ka dyshime për mos përputhshmëri të Emetuesit me kriteret e likuiditetit;
- 3) Ka ndryshime në strukturën aksionare të Emetuesit;

4) Emetuesi përthithet plotësisht (100%) nga një subjekt tjetër.

Në rastet kur ndikon në mbarëvajtjen e procesit të tregtimit, Këshillimi Mbikëqyrës i ALSE, vendos që të mos autorizojë transferimin në një segment më të ulët të tregut, titujt të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Në rastet kur transferimi i titujve nga një Segment i Tregut të Bursës ALSE, në një segment tjetër, do të krijonte ndikim negativ në tregun e bursës, Këshillimi Mbikëqyrës i ALSE mund të vendosë të mos lejojë transferimin e titujve.

Kapitulli V: PROCEDURAT E DELISTIMIT TË TITUJVE NË BURSË

Neni 21

Delistimi i Titujve nga Tregu i Bursës

Delistimi i titujve nënkupton procesin e pezullimit të përhershëm nga tregtimi dhe heqjen e titujve nga tregu zyrtar i Bursës.

Neni 22

Rastet e Delistimi të Titujve nga Bursa ALSE

Delistimi i Titujve nga Bursa ALSE mund të kryhet bazuar në rastet e mëposhtme:

- 1) Kur kërkohet nga Emetuesi për të delistuar titujt;
- 2) Nga shkaqe objektive si (por pa u kufizuar me):
 - Delistimi në rastet e Maturimit të titullit;
 - Delistimi me vendim të ALSE dhe/ose Autoriteti Kompetent.

Miratimi/Refuzimi i delistimit të titujve nga Segmentet e Tregut të bursës bëhet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bursës ALSE.

Neni 23

Delistimi i Aksioneve

Bazuar në rregulloren e Bursës ALSE, aplikimi për delistimin e aksioneve nga bursa, siç përmendet në pikën 1 të paragrafit të parë në Nenin 22 të këtij udhëzuesi, mund të dorëzohet nga vetë Emetuesi.

Në rastet kur Emetuesi kërkon me vullnetin e tij delistimin e aksioneve nga Bursa ALSE, ai duhet të dorëzojë në mënyrë të shkruar Aplikimin për Delistimin (Shtojca 2).

Në rastet kur delistimi nga Bursa ALSE kërkohet për arsye të tjera (bashkimi i kompanive, ristrukturimi ose likuidimi), Emetuesi duhet të plotësojë Aplikimin për Pezullimin e Tregtimit (Shtojca 3) dhe Aplikimin për Delistim. Bazuar në dokumentët e dorëzuar dhe në përputhje me Aplikimet e përmendura në këtë paragraf, Bursa ALSE do të ndalojë menjëherë tregtimin e titullit në fjalë.

Neni 24

Delistimi i Titujve të Borxhit

Bursa Shqiptare e Titujve ALSE do të delistojë titujt e borxhit të Emetuesit nga tregu nëse:

- 1) të gjitha detyrimet e titullit të borxhit kanë arritur maturimin;
- 2) Emetuesi nuk përmbush detyrimet e përmendura në Nenet 33, 34 dhe 35 të këtij udhëzuesi;

3) Emetuesi dorëzon me vullnetin e tij Aplikimin për Delistim (Shtojca 2).

Në rast të ndryshimit të karakteristikave të titullit të borxhit, të cilat nuk janë të pasqyruara në Prospekt dhe të cilat sjellin përfundimin e detyrimit që mbart Emetuesi, atëherë titulli i borxhit do të konsiderohet që nuk plotëson më kriteret për tregtim. Në këto raste, Emetuesi duhet të dorëzojë në Bursën ALSE Aplikimin për Delistim (Shtojca 2). Pas shqyrtimit të arsyeve për t'u delistuar, Bursa ALSE ndalon tregtimin e titullit përkatës të borxhit për ta delistuar atë më pas.

Në rastet e vendimit për të delistuar titujt e borxhit nga tregu i Bursës ALSE, përveç dorëzimit të formatit të Aplikimit për Delistim (Shtojca 2), Emetuesi duhet të dorëzojë gjithashtu vendimin e noterizuar të aksionarëve për delistimin e titujve të borxhit nga tregu i Bursës ALSE.

Kapitulli VI: Publikimi i Informacionit në Bursën ALSE

Neni 25

Dhënie e Informacioneve ndaj Bursës ALSE

Në bazë të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi, çdo kompani që është e listuar në Bursën ALSE ka për detyrim të publikojë apo t'i japë informacion Bursës lidhur me veprimet korporative, të cilat ndikojnë në çmimet e titujve të listuar ose në pozicionin dhe vendimmarrjen e mbajtësve të këtyre titujve.

Neni 26

Menyrat e Publikimit të Njofitimeve në Bursën ALSE

Të gjitha njoftimet që Emetuesi ka për detyrim që t'ia mundësojë bursës, sipas Rregullores së Bursës Shqiptare të Titujve ALSE, si dhe dokumentet bashkëngjitur tyre (siç mund të jenë por pa u kufizuar me: raportet vjetore, dividendi, pagesa e kuponave dhe veprime të tjera korporative) do t'i dërgohen bursës duke përdorur një nga mënyrat e mëposhtme:

- 1) Nëpërmjet komunikimit elektronik (e-mail) në adresën listimi@alse.al;
- 2) Nëpërmjet faqes së internetit www.alse.al/intranet.com;
- 3) Nëpërmjet postës në zyrat qendrore të Bursës ALSE;
- 4) Dorazi në zyrat qendrore të Bursës ALSE.

Neni 27

Gjuha e Përdorur në Publikimin e Informacioneve

Bazuar në Rregulloren e Bursës ALSE, kompanitë e listuara duhet t'ia mundësojnë informacionin e tyre Bursës ALSE në gjuhën Shqipe. Emetuesi mund të sjellë shtesë dhe në mënyrë vullnetare, të njëjtin informacion në gjuhën angleze.

Kapitulli VII: Shpërndarja e Informacionit për Publikun

Neni 28

Detyrimi ndaj Investuesve

Bazuar në Rregulloren e Bursës ALSE, Emetuesi i listuar në Tregun Standard dhe Tregun Kryesor, duhet:

- 1) Të sigurojë informim të barabartë publikut;
- 2) Të publikojë informacionin në mënyrë sa më lehtësisht të aksesueshëm;

- 3) Të sigurojë informacion të besueshëm;
- 4) Të sigurojë publikimin e të plotë të veprimeve të biznesit, që mund të këtë ndikim në çmimin e titullit në treg (price sensitive information).

Emetuesi i listuar në Tregun Hyrës nuk ka detyrim sipas këtij neni. Pavarësisht këtij paragrafi, Bursa ALSE publikon çdo raportim që vjen në mënyrë vullnetare nga Emetuesi, titujt e të cilit janë regjistruar dhe tregtohen në Tregun Hyrës.

Neni 29

Mënyrat e Publikimit të Informacionit për Investuesit

Në mënyrë që të plotësohen pikat e Nenit 28 të këtij udhëzuesi dhe për të siguruar transparencë në treg, informacioni për investuesit duhet të publikohet njëkohësisht, duke përdorur mënyrat e mëposhtme:

- 1) Nëpërmjet faqes së internetit www.alse.al/intranet.com;
- 2) Nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Emetuesit;

Në mënyrë që të sigurohet informim i barabartë i publikut, Emetuesit duhet të publikojnë të njëjtin informacion në të gjithë mënyrat e përmendura në këtë Nen.

Neni 30

Raportimi Periodik

Kompanitë e listuara në Tregun Standard dhe Tregun Kryesor të Bursës ALSE janë të detyruar të publikojnë raportin vjetor brenda katër (4) muajve, pas fundit të vitit financiar dhe duhet të sigurohen që raportet financiare të jenë të aksesueshme nga publiku për të paktën pesë vitet e fundit, duke filluar që nga momenti i listimit.

Raporti vjetor duhet të përmbajë të paktën informacionet e mëposhtme:

- 1) Pasqyrat financiare të audituara;
- 2) Raport vjetor nga Organet Drejtuese të Emetuesit ku përfshihet një prezantim i qartë i zhvillimeve të vitit dhe operacioneve të kompanisë.

Neni 31

Kalendari Financiar

Jo më vonë se data 31 Dhjetor e vitit aktual, kompanitë e listuara në Tregun Standard dhe Tregun Kryesor të Bursës ALSE duhet të bëjnë publike në faqen e tyre zyrtare të internetit, një kalendar për publikimet që do të bëhen prej tyre gjatë vitit pasardhës. Ky kalendar do të quhet kalendar financiar dhe në të duhet të përcaktohen datat e publikimit të ngjarjeve të mëposhtme (por pa u kufizuar në to):

- 1) Raportimet Vjetore;
- 2) Data e pagesës së dividendit dhe afatet kohore të procedurës së shpërndarjes (nëse aplikohet);
- 3) Data e pagesës së kuponit të obligacionit (nëse ka).

Në rastet kur kompania vendos të ndryshojë datat e kalendarit financiar, duhet të informojë Bursën ALSE me anë të një shkrese zyrtare (nëpërmjet postës formale apo formës elektronike), si dhe duhet t'ia bëjë të ditur publikut duke e publikuar menjëherë ndryshimet në faqen e saj zyrtare të internetit.

Kapitulli VIII: Publikimi i Informacioneve të Rëndësisë së Veçantë në Publik

Neni 32

Informacioni i Rëndësisë së Veçantë

Informacioni i rëndësisë së veçantë do të quhet ai informacion, i pa publikuar, lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me ngjarjen, veprimin, aktin, vendimin, por jo vetëm, të një ose më shumë Emetuesi/ve, dhe/apo një ose më shumë instrumenteve financiarë, i cili nëse do bëhej publik, do të kishte efekt të konsiderueshëm në çmimet e titujve përkatës në treg të Emetuesit/ve.

Bursa ALSE mund të kërkojë publikimin e informacioneve shtesë të cilat shihen me rëndësi për tregun por që nuk janë të përmendura në Nenet 33, 34, 35 më poshtë.

Neni 33

Llojet e Informacioneve të Rëndësisë së Veçantë

Kompanitë e listuara/tregtuara në Bursën ALSE janë të detyruara të publikojnë sa më shpejt të jetë e mundur, brenda një afati maksimal prej 120 minutash, pasi ngjarja, veprimi, akti, vendimi, por jo vetëm, të jetë bërë efektive, çdo informacion lidhur me biznesin e tyre dhe ngjarje të tjera që ndikojnë në kompani, të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në statusin ligjor të kompanisë dhe në pozicionin e saj financiar. Në veprimtaritë që kanë ndikim të konsiderueshëm në biznes mund përfshihen (por pa u kufizuar me):

- 1) Pezullimi i veprimtarisë së biznesit;
- 2) Ndryshime të konsiderueshme në operacionet bazë të kompanisë;
- 3) Ndryshime në Bordin Drejtues ose në Bordin Mbikëqyrës;
- 4) Ndryshime në audituesit e jashtëm;
- 5) Miratimi i kontratave të rëndësishme për firmën;
- 6) Sigurimi i patentave, licencave dhe markave tregtare;
- 7) Nxjerrja e produkteve ose shërbimeve të reja, që kanë ndikim të konsiderueshëm në veprimtarinë e kompanisë;
- 8) Çështje ligjore në proces me ndikim në veprimtarinë e kompanisë;
- 9) Raste lidhur me dëmtimin e konsumatorëve nga produktet, ose shërbimet që ofron kompania.

Neni 34

Detyrimi për të Publikuar Ndryshimet në Strukturën e Kapitalit

Një kompani e listuar/tregtuar në Bursën ALSE duhet të njoftojë publikun sa më shpejt të jetë e mundur, urgjent por jo më vonë se 24 orë, për çdo vendim që mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në strukturën e kapitalit të saj, si:

- 1) Rritja e kapitalit ose zvogëlimi i tij;
- 2) Tërheqja e titujve të emetuar;
- 3) Tërheqja e titujve të borxhit të listuar, para datës së maturimit;
- 4) Pamundësia për të përmbushur detyrimet lidhur me titujt e emetuar të borxhit;
- 5) Pamundësia paguar dividendet.

Neni 35

Detyrimi për të Publikuar Ndryshimet në Strukturën Ligjore

Një kompani e listuar në Bursën ALSE duhet të njoftojë publikun sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 24 orë, lidhur me ndryshimet në statusin juridik të saj, ku përfshihen veprimet si:

- 1) Bashkimi dhe përthithja;

- 2) Ndarja (spin-off);
- 3) Transformimi në një formë tjetër juridike;
- 4) Falimentimi ose Likuidimi.

Neni 36

Hyrja në Fuqi

Kjo udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE.

KRYETARI

HYSEN ÇELA

SHTOJCA 1
FORMULARI I APLIKIMIT PËR TRANSFERIMIN E TITUJVE NË SEGMENTET E TREGUT TË BURSËS
ALSE

Aplikanti

Data e Plotësimit

Data e Marrjes

Marrësi në Dorezim

(plotësohet nga ALSE)

1. Informacion i përgjithshëm i Emetuesit

1.1. Tregu Aktual (shënjo)	Tregu Kryesor <input type="checkbox"/>	Tregu Standard <input type="checkbox"/>	Tregu Hyrës <input type="checkbox"/>
1.1. Tregu i synuar (shënjo)	Tregu Kryesor <input type="checkbox"/>	Tregu Standard <input type="checkbox"/>	Tregu Hyrës <input type="checkbox"/>
1.2. Emetuesi	_____		
1.3. Adresa Emetuesit	_____		
1.4. NIPTI	_____		
1.5. Data e Themelimit	_____		

1.7. Informacion i përgjithshëm mbi titujt që do të transferohen

a. Simboli (kodi në bursë)	_____	
b. Klasa e Titujve	_____	
c. ISIN	_____	
d. Lloji i Monedhës (shënjo)	ALL <input type="checkbox"/>	EUR/USD <input type="checkbox"/>
e. Vlera Nominale	_____	
f. Vlera totale e emetuar	_____	

4. Aplikanti pranon të paguajë komisionet e transferimit, siç janë të përcaktuara nga ALSE.

(Firma dhe Vula e aplikantit)

SHTOJCA 2
FORMULARI I APLIKIMIT PËR DELISTIMIN E TITUJVE

Aplikanti

Data e Plotësimit

Data e Marrjes

Marrësi në Dorezim

(plotësohet nga ALSE)

1. Emetuesi

- a) Emri i kompanisë _____
- b) Qyteti i Regjistrimit _____
- c) Adresa _____
- d) NIPTI. _____

2. Titulli që kërkohet për tu delistuar nga tregu i bursës

- a) Lloji _____
- b) Simboli (Kodi i Emetuesit) _____
- c) Klasa e Titullit _____
- d) Sasia _____

3. Tregu aktual i titullit (Shenjo)

Tregu Kryesor

Tregu Standard

4. Arsyet e Delistimit

5. Vendimi për Delistim i marrë në Mbledhjen e Asamblesë Aksionere ose të Mbajtësve të Obligacioneve

- a) Data e mbledhjes _____
- b) % e totalit të aksioneve, bazuar në vendimin për ti delistuar ato, ose % totalit të të gjithë detyrimeve pjese e obligacionit, bazuar në vendimin për ta delistuar _____

c) Data e Delistimit _____

Dokumentet bashkëngjitur formularit:

- kopje e vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Emetuesit për delistimin e titujve, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi në Republikëm e Shqipërisë;

6. Data e propozuar për Delistim _____

7. Shpjegime Shtesë (nëse ka) _____

8. Bashkëngjitur Formularit

- Mandati i pagesës së komisioneve të delistimit

(Firma dhe Vula e aplikantit)

SHTOJCA 3
FORMULARI I APLIKIMIT PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË TREGTIMIT TË TITULLIT TË
EMETUESIT

Aplikanti

Data e Plotësimit

Data e Marrjes

Marrësi në Dorezim

(plotësohet nga ALSE)

1. Emetuesi _____

2. Qyteti i Regjistrimit _____

3. Adresa _____

4. NIPTI _____

5. Titulli që do pezullohet përkohësisht

a. Simboli (Kodi i Emetuesit) _____

b. Lloji i _____

Titullit _____

6. Arsyet për pezullimin e përkohshëm të tregtimit

8. Propozimi i kohëzgjatjes së pezullimit të përkohshëm të tregtimit

data e pezullimit _____

rifillimi i tregtimit (data) _____

9. Kontakti

person i kontaktit të Emetuesit _____

Tel/Cel _____

Adresa _____

(Firma dhe Vula e aplikanti)